



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 3280 Prot.

Koplik, më 26.12.2024

V E N D I M

NR. 74 , DATË 26 .12.2024

DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA

FATKEQËSITË NATYRORE PËR VITET 2016-2024

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 26.12.2024, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM.329 datë 16.05.2012 “Për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria e njerëzore”, Vendim Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, si dhe shkresës Nr.3806/1 Prot. Datë 29.03.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Emergjencat Civile, për vitin 2024”, dërguar nga Ministria e Mbrojtjes (AKMC)

V E N D O S I :

1. Dhënie e ndihmës financiare prej 9,864,851 (nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë për 23 (njëzet e tre) familje të Bashkisë Malësi e Madhe, të dëmtuara, për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia gjatë viteve 2016-2024, sipas listës bashkëlidhur:
2. Efektet: Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të dëmtuar
3. Burimi i financimit është: 7,906,091 (shtatë milion e nëntëqind gjashtë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë fond i vënë në dispozicion të Bashkisë Malësi e Madhe me shkresën Nr.3806/1 Prot. Datë 29.03.2024 “Miratimi për rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2024”, dërguar nga Ministria e Mbrojtjes (AKMC)” dhe 1,958,760 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë fond i planifikuar në Buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2024, miratuar me VKB Nr.06 datë 18.01.2024 me burim financimi nga te ardhurat e trashëguara nga viti 2023.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës dhe Sektori i Emergjencave Civile pranë bashkisë Malësi e Madhe.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratar me 26.12.2024

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 4

Zbardhur me datë 26.12.2024

